



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 471/2014

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Haka (Demiraj) Alimetaj me vendbanim në Heilbron të Gjermanisë për shkak të refuzimit të aplikacionit për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 11.08.2014 mori këtë:

### VENDIM

**Hidhet si i pasafatshëm** apeli i Haka (Demiraj) Alimetaj me vendbanim në Heilbron të Gjermanisë, mbetet në fuqi vendimi KQZ-së me nr. 20140806002305

### Arsyetim

Më datën 07.08.2014 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Haka (Demiraj) Alimetaj me vendbanim në Heilbron të Gjermanisë, kundër vendimit të KQZ-së, me te cilin i është refuzuar aplikacioni i saj që të përfshihet në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës.

PZAP-i pasi që shqyrtoi afatshmërinë e apelit gjeti se:

### **Apeli është i pasafatshëm**

PZAP-i, konstatoi se apeli i parashtruar nga Haka (Demiraj) Alimetaj, është i pasafatshëm sepse ndaj vendimeve të KQZ-së sipas nenit 122.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), afati për të parashtruar apel në PZAP është 24 orë nga momenti i shpalljes së vendimit nga KQZ-ja. Vendimin lidhur me certifikimin e e listës përfundimtare të votuesve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës është shpallur me datën 28.05.2014, ndërsa pala ka parashtruar apel në PZAP me dt.07.08.2014, nga kjo del se apeli është i pasafatshëm ngase kanë kaluar më shumë se 24 orë nga momenti i shpalljes së vendimit të KQZ-së, prandaj në kuptim të nenit 4.2 të rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 471/2014 më datën 11.08.2014

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**



**Këshillë Juridik:** PZAP nuk do t'i pranoj kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejt themelore.*